



INTERCEPTIMI I KOMUNIKIMEVE NË SHQIPËRI

Legjislacioni dhe Praktika

Arjan Dyrmishi

**Qendra për Çështje Europiane dhe të Sigurisë
IDN (Dokumente Politikash – Seria III / no 1, 2010)**

Qershor 2010

Mbështetur nga OSI Think Tank Fund (Budapest)

Abstrakt

Në një studim të publikuar përpara një viti,¹ IDN ka trajtuar kontrollin dhe mbikqyrjen e përgjimit të telekomunikimeve në Shqipëri, duke bërë një ballafaqim të legjislacionit respektiv me standardet dhe praktikat më të mira. Këto standarde sugjerojnë se duhet të ekzistojnë mekanizma mbikëqyrjeje dhe kontrolli që të garantojnë se autoriteti që u delegohet shërbimeve informative dhe të zbatimit të ligjit për përgjimin e komunikimeve duhet të përdoret vetëm kur përcaktohet nga kritere strikte ligjore dhe se ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori duhet të marrin përgjegjësitë e tyre në procesin e kontrollit dhe mbikëqyrjes. Në tetor 2009 ligji për përgjimin e telekomunikimeve u amendua për të dytën herë, duke shtuar numrin e institucioneve me kompetenca dhe akses ndaj përgjimeve, por pa sjellë ndonjë përmirësim të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Në vijim të analizës së një viti më parë, ky studim paraqet një analizë më të thelluar të legjislacionit dhe të praktikave që aplikohen në realizimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjimit të telekomunikimeve, duke sjellë dhe krahasime me legjislacionin dhe praktikat e zbatuara në vende me demokraci të konsoliduar.

Studimi vlerëson se kontrolli dhe mbikëqyrja e procesit të përgjimeve, si garanci për të shmangur përdorimin e përgjimeve për qëllime abuzive dhe antiligjore dhe respektuar liritë themelore, janë ose inekzistent ose tepër formale dhe për këtë sugjeron se është i nevojshëm rishikimi i legjislacionit me qëllim rregullimin e mekanizmave kontrollues dhe mbikëqyrës.

Fjalë kyçe: *përgjimi i telekomunikimeve, metodat e veçanta të hetimit, të drejtat themelore të njeriut, kontrolli dhe mbikëqyrja,*

¹ Arjan Dyrmishi, 'Interceptimi i Komunikimeve në Shqipëri: Kontrolli dhe Mbikëqyrja', IDN, Qendra për Çështje Europiane dhe të Sigurisë. Maj 2009
www.idmalbania.org/publications/alb/Bacgrounder_Intercept.pdf

1. Hyrje

Mundësia për të komunikuar në mënyrë të lirë dhe me një nivel të garantuar privatësie është një nga parimet themelore të sanksionuara në dokumentet themelore të shteteve. Megjithatë, kjo nuk ka penguar që institucionet informative historikisht të bëjnë përpjekje për të marrë informacion me mënyra të fshehta duke përdorur teknika nga ato më të thjeshtat, si hapja e letrave për leximin e përmbajtjes së tyre, deri tek përdorimi i teknologjive të sofistikuara të interceptimit të telekomunikimeve.

Kështu, ecuria e zhvillimit të legjislacionit dhe praktikave në fushën e interceptimit të telekomunikimeve është përcaktuar nga dy faktorë kryesorë, evolucioni i të drejtave themelore të njeriut dhe zhvillimi i teknologjisë së telekomunikimeve, në një mjedis ku nevoja për më shumë siguri ka ardhur gjithnjë në rritje.²

Këshilli i Europës, duke e konsideruar interceptimin e telekomunikimeve si një ‘metodë të veçantë të hetimit’, i cili prek drejtpërsëdrejti liritë dhe të drejtat themelore,³ ka rekomanduar që një aktivitet i tillë duhet të rregullohet me ligj, i cili jo vetëm duhet të jetë veçanërisht i saktë por të bëjë të mundur gjithashtu që ligjshmëria e përdorimit të këtyre metodave të provohet përpara një gjykate.⁴ Po kështu, Parlamenti Europian rekomandon që ndërhyrja me të drejtat e garantuara nga Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore duhet të bëhet me ligj dhe bazuar në nevojën e një shoqërie demokratike në interes të sigurisë kombëtare.⁵ Në këtë linjë, Shqipëria miratoi për herë të parë një ligj për përgjimin e telekomunikimeve në dhjetor 2003, i cili deri diku shërben si instrument bazë për kryerjen e përgjimeve dhe plotësimin e nevojave informative të institucioneve të interesuara por, që në fakt, nuk ofron asnjë klauzolë për krijimin e mekanizmave për kontrollin dhe mbikqyrjen e zbatimit të tij. Ndërkohë që ky ligj është amenduar dy herë (në vitin 2008 dhe 2009) më qëllim rritjen e numrit të institucioneve me akses ndaj përgjimeve, nuk është bërë ndonjë përmirësim në drejtim të mbikëqyrjes së zbatimit të ndërtimit të mekanizmave të kontrollit për zbatimin e këtij ligji.

² Council Resolution of 17 January 1995 on the lawful interception of telecommunications *Official Journal C 329, 04/11/1996 P. 0001 - 0006*

³ H. Born and I. Leigh ‘Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies, Faqe 37

⁴ Council of Europe, ‘*Guidelines on human rights and the fight against terrorism*’, Adopted by the Committee of Ministers on 11 July 2002 at the 804th meeting of the Ministers’ Deputies, Faqe 9 dhe 23

<http://www1.umn.edu/humanrts/instrree/HR%20and%20the%20fight%20against%20terrorism.pdf>

⁵ EP REPORT, PE 229.986/fin.A4-0243/99, 23 April 1999, on the draft Council Resolution on the lawful interception of telecommunications in relation to new technologies (10951/2/98 - C4-0052/99 - 99/0906(CNS))

Duke qenë se përgjimet kryhen nga institucione informative dhe të zbatimit të ligjit, mbikëqyrja e të cilave rregullohet nga ligjet organike të tyre, mund të supozojmë se edhe mbikëqyrja ndaj procesit të përgjimeve është kryer duke u rregulluar me këto ligje.

Në përpjekje për të vlerësuar praktikën për realizimin e përgjimit të telekomunikimeve dhe procesin e mbikëqyrjes sipas parimeve dhe standardeve demokratike ndërkombëtare, ky studim analizon legjislacionin për përgjimet, ligjet organike të institucioneve që kanë të drejtë për përgjim si dhe mënyrën e realizimit të kontrollit të brendshëm, nga ekzekutivi, nga legjislativi dhe nga institucionet e pavarura. Së fundi, studimi sjell për krahasim dy modele europiane dhe disa rekomandime.

2. Praktika pararendëse

Në Shqipëri përgjimi i telekomunikimeve ka qenë një praktikë e përdorur edhe përpara miratimit të ligjit për përgjimin e telekomunikimeve, por në mungesë të një legjislacioni të përgjithshëm që të rregullonte këtë praktikë në mënyrë të centralizuar, përgjimi kryhej duke u bazuar në legjislacionin organik që rregullonte aktivitetin e shërbimeve sekrete apo institucioneve të zbatimit të ligjit.

Kështu ligji i parë organik i Shërbimit Informativ Kombëtar lejonte realizimin e përgjimit me miratim nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili ishte autoriteti përgjegjës edhe për ushtrimin e kontrollit mbi zbatimin e kësaj procedure.⁶ Edhe ligji i mëvonshëm organik i këtij shërbimi, i miratuar në vitin 1998, la në fuqi të njëjtën procedurë.⁷ Ndërsa ligji për Shërbimin Informativ Ushtarak, i miratuar në vitin 2003, përcakton një procedurë mikse të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes dhe të pranuar e të nënshkruar nga Prokurori i Përgjithshëm.⁸ Akti, i cili deri diku parashikonte një procedurë më të qartë për realizimin e përgjimeve ishte Kodi i Procedurës Penale, që kryesisht përdorej nga policia dhe prokuroria të cilat mund të përdornin rezultatet e përgjimeve sipas kësaj procedure dhe si provë në gjykatë.⁹

Bumi i komunikimeve që erdhi si pasojë e hyrjes në treg të telefonisë mobile, kërkesat kushtetuese,¹⁰ dhe standardet ndërkombëtare për përdorimin e metodave të veçanta të hetimit

⁶ Ligj Nr. 7495, datë 2.7.1991, Për Organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar. Neni 4

⁷ Ligj Nr. 8391, datë 28.10.1998, Për Shërbimin Informativ Kombëtar. Neni 6

⁸ Ligj Nr. 9074, Datë 29.5.2003 Për Shërbimin Informativ Ushtarak. Neni 12

⁹ Ligj Nr. 7905, datë 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë. Nenet 221-226

¹⁰ Kushtetuta e Shqipërisë, Nenet 15-17

vetëm me legjislacion të veçantë,¹¹ bënë prezent si nevojën e përdorimit të teknologjisë së përparuar ashtu dhe miratimin e një ligji të përgjithshëm për të rregulluar përgjimin e telekomunikimeve nga shërbimet informative dhe institucionet e zbatimit të ligjit.

3. Ligji për përgjimin e telekomunikimeve

Ligji për përgjimin e telekomunikimeve përmban pesë pjesë; dispozitat e përgjithshme, procedurat për kryerjen e përgjimit, kërkesat e veçanta që lidhen me përgjimin, detyrimet e operatorëve të telekomunikimeve, mënyrën e kryerjes së përgjimeve me vendim gjykatë dhe autoritetet për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Në pjesën e parë, dispozita të përgjithshme, përcaktohet si qëllim i ligjit *'rritja e efektivitetit të punës së institucioneve shtetërore'*,¹² duke e balancuar deri diku këtë objektiv me parimet e bazë që duhet t'u përmbahet si *'respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut'*, *'nevojshmëria'* dhe *'proporcionaliteti'*.¹³

Ajo, që më së shumti intereson këtë studim, është pikërisht fakti se sa dhe si gjatë implementimit të këtij ligji, këto parime themelore mbahen parasysh qoftë nga institucionet zbatuese ashtu qoftë nga institucionet e ngarkuara me kontrollin demokratik.

Siç u përmend më sipër, ky ligj nuk përmban ndonjë klauzolë për të përcaktuar institucionet përgjegjëse për kontrollin demokratik, përveç kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm, prandaj në mënyrë hipotetike thjesht mund të shpresohet se institucionet që aplikojnë përgjimin i kanë këto parime si vlera themelore.

4. Kërkesat për kryerjen e përgjimit

Brenda fushës së veprimtarisë së përcaktuar në ligjet organike respektive,¹⁴ Shërbimi Informativ Shtetëror, shërbimet informative dhe policore të Ministrisë së Brendshme, të Mbrojtjes,

¹¹ Council of Europe, *'Guidelines on human rights and the fight against terrorism'*, Adopted by the Committee of Ministers on 11 July 2002 at the 804th meeting of the Ministers' Deputies, Faqe 9 dhe 23

<http://www1.umn.edu/humanrts/instrree/HR%20and%20the%20fight%20against%20terrorism.pdf>

¹² Ligji për Përgjimet, Neni 2

¹³ Ligji për Përgjimet, Neni 4

¹⁴ Ligji për Përgjimet, Neni 6, paragrafi 2

Drejtësisë dhe Financave,¹⁵ kanë të drejtë të kërkojnë përgjim për të siguruar të dhënat e domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre.¹⁶

Për të fituar të drejtën për përgjim shërbimet infomative dhe policore duhet të bëjnë një kërkesë ku të përcaktojnë subjektin që do të përgjohet, pajisjet fundore që do të përgjohen,¹⁷ arsyet e përgjimit si dhe afatin kohor.¹⁸ Autoriteti përgjegjës për miratimin e kërkesës për përgjim është Ministri i cili ka në varësi shërbimin informativ ose policor ose Drejtori, në rastin e SHISH.¹⁹ Për përgjimet sipas Kodit të Procedurës Penale,²⁰ kërkesat për përgjim miratohen nga prokurori i çështjes me kërkesë të oficerit të policisë gjyqësore.²¹

Dy amendimet e bëra në Ligjin për Përgjimet (LP),²² përfshirja e përgjimeve si metodë pune e specifikuar në ligjet e miratuara në vitet e fundit për Policinë e Shtetit,²³ për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme,²⁴ si dhe propozimet e fundit për ndryshimin e ligjit për SHISH, ku kërkohej pikërisht zgjerimi i fushës së veprimit të këtij institucioni me qëllim edhe zgjerimin e kategorive të subjekteve që mund të përgjojë, tregojnë se ka një përdorim gjithnjë e më të dendur të kësaj praktike.

5. Miratimi për kryerjen e përgjimit

Autoriteti që miratim vendimet për përgjim është Prokurori i Përgjithshëm. Për t'i dhënë mundësinë Prokurorit të Përgjithshëm (PP) që të kontrollojë zbatimin e vendimit të marrë, ligji i jep të drejtën të kontrollojë procesin teknik të komandimit të sistemit të përgjimeve,²⁵ dhe të njihet me rezultatet e përgjimit, si gjatë afatit të përgjimit ashtu edhe pas përfundimit të tij.²⁶

¹⁵ Aksesi për përgjim i Ministrisë së Brendshme, të Mbrojtjes, të Financave dhe Drejtësisë ka ardhur duke u rritur me dy amendimet që i janë bërë ligjit në vitin 2008 dhe 2009.

¹⁶ Ligji për Përgjimet, Neni 6, paragrafi 1

¹⁷ 'Pajisja fundore' është përkufizimi i përdorur në ligj për numrin e telefonit që interceptohet.

¹⁸ Ligji për Përgjimet, Neni 7

¹⁹ Ligji për Përgjimet, Nenet 8 dhe 17

²⁰ Kodi i Procedurës Penale, i përditësuar me praktikë gjyqësore, Dhjetor 2008

²¹ Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm Nr.1 Datë 21.04. 2006, 'Për Përgjimet'

²² <http://www.pp.gov.al/sq/home/legjislacion/Ligje/akte%20normative%20te%20PP/UDHEZIME/2002%20-%202006/7.pdf>

²³ Ligj Nr.9885, Datë 3.3.2008, Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr.9157, Datë 4.12.2003, "Për Përgjimin e Telekomunikimeve", dhe Ligj Nr.10 172, Datë 22.10.2009, Për disa Shtesa në Ligjin Nr.9157, Datë 4.12.2003 "Për Përgjimin e Telekomunikacioneve",

²⁴ Ligj Nr. 9749, datë 4.6.2007, Për Policinë e Shtetit, Neni 116

²⁵ Ligj Nr.10 002, datë 6.10.2008, Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, Neni 24

²⁶ Ligji për Përgjimet, Neni 13

²⁶ Ligji për Përgjimet, Neni 15

PP mund të revokojë vendimin për përgjim kur gjykon se përgjimi nuk është më i vlefshëm sipas ligjit.²⁷ Për përgjimet e miratuara me vendim gjykate sipas Kodit të Procedurës Penale, përveç dispozitës për të drejtën e ankimit ndaj vendimit për përgjim,²⁸ gjykata si autoritet miratues nuk ka të drejtë revokimi të njëanshën të përputhshmërisë ligjore me vendimin, të ngjashme me kompetencën e Prokurorit të Përgjithshëm sipas LP.

Ligji përcakton si afat për vendimet për përgjim një periudhë maksimale tre mujore, e cila mund të zgjatet, por çdo zgjatje nuk mund jetë më tepër se tre muaj.²⁹ Ndërsa për përgjimet me vendim gjykate, afati fillestar nuk mund t'i kalojnë pesëmbëdhjetë ditë por mund të përsëritet për njëzet ditë për krime dhe dyzetë ditë për krime të rënda.³⁰

Për situatat emergjente, LP parashikon miratimin e përgjimit nga PP me *'kërkesë verbale të drejtuesit të institucionit'* i cili duhet që të paraqesë brenda 24 orëve kërkesën me arsyet e veprimeve emergjente së bashku me përgjimet e realizuara branda këtij afati.³¹ LP parashikon *'ndërprerjen e menjëhershme të përgjimit'* në rast mos plotësimi i këtij kushti, por nuk parashikon ndonjë klauzolë për shmangien e përdorimit abuziv të kësaj praktike. Në të njëjtën mënyrë, edhe Kodi i Procedurës Penale parashikon përgjimin për situata emergjente me vendim të prokurorit të çështjes duke njoftuar gjykatën jo më vonë se 24 orë.³²

Në ndryshim nga LP, Kodi i Procedurës Penale parashikon edhe interceptimin e ligjshëm pa vendim të një autoriteti tjetër, në rastin konkret të gjykatës, por vetëm me miratim të prokurorit kur *'njëri nga dy personat që do të përgjohen është i gatshëm për t'u përgjuar sipas marrëveshjes me prokurorin'*.³³

6. Mekanizmat kufizues

LP parashikon disa mekanizma kufizues, ku së pari është përjashtimi i përdorimit të përgjimeve të marra sipas këtij ligji si provë në një proces penal.³⁴ Po kështu, institucionet që u jepet e drejta për përgjim duhet të ndërmarrin masa për ruajtjen e sekretit, ndalimin e përgjimit pa autorizim ose jashtë procedurave të ngarkuara nga Prokurori i Përgjithshëm, si dhe kufizime për

²⁷ Ligji për Përgjimet, Neni 18

²⁸ Kodi i Procedurës Penale, Neni 222/a

²⁹ Ligji për Përgjimet, Neni 14

³⁰ Kodi i Procedurës Penale, Neni 222

³¹ Ligji për Përgjimet, Neni 17

³² Kodi i Procedurës Penale, Neni 222

³³ Kodi i Procedurës Penale, Neni 222, paragrafi 1

³⁴ Ligji për Përgjimet, Neni 5

përdorimin, mbajtjen dhe kopjimin e materialeve të përgjimit. Nëse këto materiale vlerësohen se nuk mund të përdoren për ‘ruajtjen e jetës, sigurisë kombëtare, rendit publik ose parandalimin e krimeve të rënda’, ato asgjësohen menjëherë.³⁵

Për të shmangur abuzimin me kapacitetet e sistemit, LP parashikon që ‘*sistemi i përgjimit kurdoherë duhet të jetë i përbërë nga dy pjesë, të cilat nuk mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra*’.³⁶

Në zbatim të kësaj klauzole PP ka kontrollin mbi atë pjesë të sistemit elektronik që lejon ose ndërpret përgjimin. Në fakt është e paqartë se si kjo kërkesë zbatohet për sistemin e vendosur në Prokurorinë e Përgjithshme,³⁷ pasi si LP ashtu edhe Kodi i Procedurës Penale nuk përmbajnë ndonjë dispozitë ku të specifikohet se kush kontrollon ‘bërthamën elektronike’ të PP.

LP ngarkon PP, Drejtorin e SHISH, dhe me amendimet e vitit 2008 edhe Ministrin e Brendshëm që të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e mekanizmave kufizues.³⁸

Edhe Kodi i Procedurës Penale përcakton kufizime për mospërdorim të përgjimeve në procese të tjera, përveç kur janë të domosdoshme për hetimin e krimeve si dhe për asgjësimin e materialeve të përgjimit.

Por, si LP ashtu edhe Kodi i Procedurës Penale nuk parashikojnë procedura sipas të cilave edhe mbasi materialet të jenë asgjësuar, të ekzistojë garancitë për një kontroll objektiv dhe të paanshëm nga institucione të tjera si ekzekutivi, legjislativi apo gjyqësori. Gjithashtu, një nga mangësitë kryesore të LP në drejtim të respektimit të të drejtës së privatësisë është mungesa e të ashtuquajturave ‘procedura minimizuese’,³⁹ për të kufizuar në minimum marrjen, mbajtjen dhe shpërndarjen e informacionit të marrë nëpërmjet përgjimit, i cili nuk përbën informacion të vlefshëm për çështjen.⁴⁰

7. Kontrolli i Brendshëm

³⁵ Ligji për Përgjimet, Neni 20

³⁶ Ligji për Përgjimet, Neni 12

³⁷ Raportim i Prokurores së Përgjithshme të Republikës, ‘Mbi Gjendjen e Kriminalitetit në Shqipëri për Vitin

³⁸ Ligji për Përgjimet, Neni 24

³⁹ Këto procedura aplikohen për të kufizuar marrjen ruajtjen dhe shpërndarjen e informacioneve të përgjuara të natyrës finiliare ose midis mjekut dhe pacientit apo palës mbrojtëse dhe klientit etj. Këto kategori janë subjekt përcaktimi nga legjislacioni dhe ndryshojnë sipas vendit. Psh, sipas legjislacionit Italian, rregulli për konfidencialitetin profesional, ndalojnë interceptimin e bisedave me klerikët fetarë, doktorët, avokatët dhe profesionistët e tjerë që futen në këtë kategori.

⁴⁰ Foreign Intelligence Surveillance Act. US Code Collection, Title 50, Chapter 36, Subchapter I, Section 1801–1811. Section 101(h)
<http://www.law.cornell.edu/uscode/50/ch36.html>

Kontrolli i brendshëm është një instrument i cili garanton që politikat dhe ligjet e miratuara nga parlamenti dhe qeveria të zbatohen në mënyrë efikase, profesionale dhe brenda kufijve ligjorë.⁴¹ Por, nga ana tjetër kontrolli i brendshëm është një nga elementët thelbësorë të kontrollit demokratik pasi gjetjet dhe konkluzionet e kontrollit të brendshëm zakonisht shërbejnë si pikënisje për kontrole të mëtejshme nga ekzekutivi, parlamenti apo nga institucionet e pavarura. LP nuk parashikon ndonjë klauzolë për të përcaktuar praktikën dhe mënyrën e kryerjes së kontrollit të brendshëm. Duke pasur parasysh që kultura institucionale dhe ekspertiza në trajtimin e çështjeve të sigurisë, hetimit por dhe sensibilitetit ndaj të drejtave të njeriut është e ndryshme në mbi shtatë institucione që, ose kanë të drejtë miratimi vendimesh për përgjim, ose kanë të drejtë përgjimi, ose të dyja si në rastin e PP, por ajo që mund të supozohet me siguri është se cilësia e kontrollit është e ndryshme në institucione të ndryshme.

Një vlerësim të saj do të bëhet më poshtë, duke analizuar mënyrat e kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit mbi përgjimet nga ekzekutivi dhe parlamenti. Por, le të këqyrim kompetencat kontrolluese të institucioni të PP, i cili ka kompetenca mjaft të gjera kontrolli, të cilat i kalojnë deri diku ato të kontrollit të brendshëm.

Sipas legjislacionit pararendës që rregullonte procedurat e përgjimit përpara vitit 2003, por ndoshta për inerci edhe sipas LP, Prokurori i Përgjithshëm është autoritet kyç në procesin e përgjimeve pasi funksionet e tij, së bashku me kompetencat sipas Kodit të Procedurës Penale, përfshijnë:

- a) Miratimin dhe zgjatjen e vendimeve për përgjim sipas LP,
- b) Kontrollin teknik i sistemit dhe i rregjistrimit të përgjimeve,⁴²
- c) Të drejtën e miratimit të punonjësve të Sektorit të Përgjimeve,⁴³
- d) Njohjen me rezultatet e përgjimit
- e) Revokimin e njëanshëm të vendimeve për përgjim
- f) Miratimin e vendimeve për përgjim në situata emergjente sipas LP
- g) Përgjimin në situata emergjente pa vendim gjykate sipas Kodit të Procedurës Penale,⁴⁴

⁴¹ H.Born & I. Leigh ‘Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. Faqe 23

⁴² Sipas kësaj kompetence PP tenikisht bën të mundur vendosjen në përgjim të një numri telefoni

⁴³ Ligji për Përgjimet, Neni 12. Këtu përfshihen punonjësit e SHISH dhe të gjithë institucioneve që sipas Ligjit për Përgjimet kanë të drejtë të kenë personelin e tyre në këtë sektor.

- h) Miratimin për kopjimin dhe ruajtjen e materialeve të përgjimit
- i) Kryrjen e përgjimeve në mjediset e zyrave të PP, në të njëjtën mënyrë si institucionet e tjera që kanë të drejtë për përgjim.⁴⁵
- j) Nxjerrjen e akteve nënligjore për
 - i. mënyrën e detajuar të realizimit të proceseve të përgjimit
 - ii. rregullat për ruajtjen e sekretit dhe të dokumentacionit të dalë nga procesi i përgjimit
 - iii. mënyrën e ruajtjes dhe asgjësimit të materialit të përgjimit

Nga kjo shumë kompetencash, përveç kompetencës për kontrollin e brendshëm të zbatimit të legjislacionit për përgjimet nga vetë Prokuroria, shihet se PP ka edhe kompetenca kontrolli të jashtëm ndaj institucioneve për të cilat ai miraton si vendimet për përgjimet, ashtu edhe për përdorimin e metodave të tjera të veçanta të hetimit dhe marrjes së informacionit.

Për zbatimin e kompetencave si kontrollues i jashtëm i institucioneve informative dhe të zbatimit të ligjit PP raporton në Kuvend. Ndërsa për ato kompetenca për të cilat PP është vetë zbatues i legjislacionit, ky institucion është subjekt kontrolli nga institucioni i Avokatit të Popullit, dhe Ministrisë të Drejtësisë i cili nga ana e vet raporton në Kuvend në të njëjtin komision të përhershëm ku raporton edhe PP.⁴⁶

8. Kontrolli nga ekzekutivi

Një nivel tjetër kontrolli është kontrolli nga ekzekutivi i cili përqëndrohet në vënien e detyrave dhe prioriteve ndaj shërbimeve informative, përfshirë kontrollin nga ministrat mbi shërbimet që kanë në varësi, kontrollin ndaj operacioneve, kontrollin ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar dhe masat për shmangien e abuzimeve nga drejtuesit e shërbimeve.⁴⁷

Meqënëse LP nuk përmban asnjë klauzolë për garantimin e kontrollit nga ekzekutivi mbi procesin e përgjimeve, duke pasur parasysh që janë tre kategori institucionesh që miratojnë ose

⁴⁴ Kjo është një kompetencë që në fakt e kanë të gjithë prokurorët që hetojnë një çështje por që PP është përgjegjës për përdorimin e ligjshëm të kësaj kompetence.

⁴⁵ Një nga aspektet më të paqarta në lidhje me këtë kompetencë, është mënyra sesi realizohet kushti i ndarjes në dy pjesë të sistemit, i cili duhet që gjithmonë të jetë i ndarë midis autoritetit miratues dhe atij zbatues të vendimit për përgjim. Sipas këtij kriteri duhet që të ishte Gjykata autoriteti i cili duhet të kontrollonte ‘Bërthamën Komanduese’ të sistemit të Përgjimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

⁴⁶ Ky argument do të trajtohet më në detaje në paragrafin e mëposhtëm për kontrollin parlamentar.

⁴⁷ H.Born & I. Leigh ‘Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. Faqe 23

kryejnë përgjime, ose të dyja bashke, edhe mënyra e kontrollit nga ekzekutivi është e ndryshme pasi bazohet në ligjet organike të këtyre institucioneve.

Kështu shërbimet informative dhe policore që janë në varësi të ministrive, e plotësojnë të paktën formalisht kriterin e sipërpërmendur sipas praktikave më të mira sepse janë në varësi të ministrave, SHISH kontrollohet nga Këshilli i Ministrave drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet Inspektorit të Përgjithshëm,⁴⁸ ndërsa Prokuroria e Përgjithshme është subjekt kontrolli i Ministrisë së Drejtësisë.⁴⁹

Ndërsa për kontrollin nga Ministria e Drejtësisë të Prokurorisë së Përgjithshme do të flitet më poshtë, nuk ka ndonjë të dhënë publike apo raportim të Inspektorit të Përgjithshëm *të bërë publike* për zbatimin e legjislacionit mbi përgjimet.

Kontrolli nga ekzekutivi është i specifikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në legjislacionin që rregullon përgjimin e telekomunikimeve dhe përbën një praktikë të konsoliduar në vendet me demokraci funksionale. Kështu sipas legjislacionit francez, Kryeministri është përgjegjës për miratimin e vendimeve për përgjim,⁵⁰ si dhe për të organizuar në mënyrë të centralizuar ekzekutimin e përgjimeve duke qënë përgjegjës për përcaktimin e numrit maksimal të interceptimeve që mund të kryhen në të njëjtën kohë dhe shpërndarjen e kuotave të interceptimit sipas institucioneve.⁵¹ Po kështu Presidenti, si kryetari i ekzekutivit, emëron Kryetarin e Komisionit Kombëtar për Kontrollin e Interceptimeve të Sigurisë si institucioni kryesor përgjegjës për kontrollin e përgjimeve.⁵²

Edhe legjislacioni britanik përcakton Sekretarin e Shtetit,⁵³ si autoritet përgjegjës për miratimin e vendimeve për përgjim.⁵⁴ Ndërsa Kryeministri, si kryetari i ekzekutivit, ka autoritetin për të emëruar Komisionerin për Interceptimin e Komunikimeve, si institucioni kryesor përgjegjës për

⁴⁸ Ligj Nr.8391, datë 28.10.1998, Për Shërbimin Informativ Kombëtar, ndryshuar me Ligj Nr. 9400, datë 12.5.2005, Nenet 4 dhe 12.

⁴⁹ Ligj Nr.8737, datë 12.2.2001, Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë,(ndryshuar me Vendim të Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 13.02.2002 , me ligjin nr. 9102, datë 10.07.2003, me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008), Nenet 54 dhe 56

⁵⁰ Duhet pasur parasysh se Franca është republikë gjysëm-presidenciale dhe autoriteti më i lartë i ekzekutivit është Presidenti i Republikës jo Kryeministri.

⁵¹ Loi n°91-646 du 10 juillet 1991 relative au secret des correspondances émises par la voie des communications électroniques.NOR: JUSX9100068L .Version consolidée au 31 décembre 2008. Article 4-5

⁵² Interceptime të sigurisë ka kuptimin e interceptimeve që nuk merren sipas këtij ligji, por jo ato që merren sipas Kodit të Procedurës Penale.

⁵³ Sipas traditës qeverisëse britanike Sekretari i Shtetit është një autoritet i emëruar direkt nga Kryeministri i cili njihet dhe si ‘Sekretari Kryesor i Shtetit për...., dhe mund të jetë Ministri i Brendshëm, i Jashtëm ose i Financave.

⁵⁴ Regulation of Investigatory Powers Act 2000 (c. 23), Part I, Chapter I, 7

http://www.opsi.gov.uk/acts/acts2000/ukpga_20000023_en_2#pt1-ch1

kontrollin e përgjimeve, i cili mbikëqyr si zbatimin e ligjit nga Sekretari i Shtetit që miraton vendimet për përgjim, ashtu edhe institucionet që kanë të drejtë për përgjim.⁵⁵

Po kështu Ministrat e Brendshëm miratojnë vendimet për përgjim në Gjermani dhe Hollandë.⁵⁶

9. Kontrolli nga institucionet e pavarura

Kontrolli nga institucionet e pavarura realizohet nga ato institucione pavarësia e të cilave garantohet me ligj dhe nëpërmjet mekanizmave të emërimit dhe raportimit.⁵⁷ Institucione të pavarura me rol në procesin e përgjimeve që janë analizuar në këtë studim janë Prokurori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit.

Institucioni kryesor i krijuar nga Kushtetuta në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit është Avokati i Popullit. AP ka buxhet të veçantë, zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe paraqet raport vjetor përpara tij.⁵⁸

Për kryerjen e aktivitetit kontrollues dhe mbikëqyrës për zbatimin e detyrimeve kushtetuese në mbrojtje të të drejtave të individit, AP ka një komisioner të dedikuar dhe një 'seksion për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor'.⁵⁹

Nga studimi i raporteve të paraqitura nga AP në Komisionin e Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me përjashtim të një rasti të shqyrtuar mbas ankesës së një qytetari,⁶⁰ nuk ka asnjë të dhënë tjetër që të tregojë se ky institucion ka ushtruar kontroll mbi zbatimin e ligjit për përgjimet, qoftë në drejtim të institucioneve që kanë të drejtë të përgjojnë qoftë në drejtim të Prokurorisë si institucion me kompetenca të dyfishta.

⁵⁵ Regulation of Investigatory Powers Act 2000 (c. 23), Section 57

http://www.opsi.gov.uk/acts/acts2000/ukpga_20000023_en_2#pt1-ch1

⁵⁶ Ministry of Justice, Fact Sheet on the Special Investigation Powers Act

<http://www.justitie.nl/english/Publications/factsheets/bob.asp?ComponentID=35268>

⁵⁷ H.Born & I. Leigh 'Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. Faqe 139

⁵⁸ Kushtetuta e RSH, Nenet 60-63

⁵⁹ Ligji Nr.8454, datë 4.2.1999, Për Avokatin e Popullit, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, Neni 31

⁶⁰ Raport për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, 1 Janar – 31 Dhjetor, Viti 2006

http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/Raporti_2006.pdf

Edhe Prokurori i Përgjithshëm si institucion i sanksionuar në Kushtetutë,⁶¹ raporton në Kuvend ose komisionet parlamentare të paktën një herë në gjashtë muaj,⁶² por zakonisht ky raportim bëhet një herë në vit.

Nga studimi i raporteve të paraqitura nga PP që nga viti 2006 në Komisionin e Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, apo në seancw plenare vërehet një zbehje të vazhdueshme e praktikës raportuese të këtij institucioni në lidhje me zbatimin e legjislacionit për përgjimet.

Në raportin e PP mbi aktivitetin vitit 2006 për herë ta parë u publikuan disa statistika dhe të dhëna,⁶³ të cilat edhe pse në vetvete nuk ishin një tregues i vullnetit për të krijuar një praktikë e cila do të jepte mundësinë e gjenerimit të një debati të hapur të faktorwve institucionalë dhe shoqërorë. Por në raportimet e viteve të mëpasme të PP nuk japet pothuajse asnjë e dhënë për të shpjeguar se si ky institucion i ka përmbushur detyrimet ligjore të sipërpërmendura, përveç disa detajeve për përdorimin ‘e suksesshëm’ të përgjimeve dhe zgjerimin e kapaciteteve teknike të përgjimit.

10. Kontrolli nga legjislativi

Mbikqyrja parlamentare përmbush një funksion të rëndësishëm në sistemin e kontrollit dhe balancës nëpërmjet mbikqyrjes së politikës së përgjithshme, financave dhe ligjshmërinë e shërbimeve.⁶⁴ Në tërësi ka një aktivitet mbikqyrës *a priori* të Kuvendit, i cili mbështetet në Kushtetutë dhe konsiston në ekskluzivitetin e parlamentit për të miratuar ligje,⁶⁵ dhe në Rregulloren e Kuvendit e cila përcakton komisionet e përhershme parlamentare që ndjekin procesin ligjvënës sipas disa fushave të caktuara.⁶⁶

Fakti që legjislativi gjatë procesit ligjvënës nuk ka arritur të parashikojë mekanizmat e kontrollit të diskutuara deri tani demonstiron se kontrolli parlamentar *a priori* nuk ka funksionuar. Ajo që mund të marrim si të mirëqënë është se ligjvënësi, po *a priori*, ka konsideruar si të mjaftueshëm

⁶¹ Kushtetuta e RSH, Nenet 148-149

⁶² Ligj Nr.8737, datë 12.2.2001, Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, Neni 53

⁶³ A.Rama, Sollaku Shqipëria përgjime sa SHBA, Gazeta Shekulli 13 Mars 2007
<http://www.shekulli.com.al/news/45/ARTICLE/6270/2007-03-13.html>

⁶⁴ H.Born & I. Leigh ‘Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. Faqe 23

⁶⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Nenet 81-85

⁶⁶ Rregullorja e Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, ndryshuar me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008 dhe vendimi nr. 21, datë 27.12.2010, Neni 19

për realizimin e kontrollit në të tërë nivelet kuadrin ligjor organik të institucioneve të ngarkuara me funksione të ndryshme në procesin e përgjimit si dhe tërësinë e akteve që rregullojnë marrdhëniet midis institucioneve të ekzekutivit, të institucioneve mbikqyrëse të pavarura dhe legjislativit.

Por, le të shohim se si nëpërmjet kontrollit *a posteriori*, Kuvendi e ka mbikqyrrur zbatueshmërinë e legjislacionit për përgjimet si në aspektin e efektshmërisë ashtu edhe në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut.

Në dy legjislaturat e fundit kontrolli dhe mbikqyrja e aktivitetit të shërbimeve sekrete dhe të sigurisë është mbuluar nga tre komisione parlamentare.

- a) Komisioni i Përhershëm Parlamentar për Sigurinë Kombëtare (KPPSK), i cili është përgjegjës për çështje të organizimit të mbrojtjes kombëtare dhe Forcave të Armatosura, bashkëpunimin ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendin publik dhe shërbimet sekrete. Tek ky komision, për çështje që kanë të bëjnë kryesisht me performacën, institucionet e sigurisë raportojnë direkt, si në rastin e Shërbimit Informativ Shtetëror, apo indirekt në rastin e shërbimeve që janë të vendosura në brëndësi të strukturave të ministrive të ndryshme.
- b) Komisioni i Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KPPÇLAPDNJ), i cili indirekt ushtron kontrollin për performancën e institucioneve të sigurisë në zbatimin e legjislacionit mbi të drejtat e njeriut, nëpërmjet raportimit në institucione të pavarura të kontrollit dhe mbikëqyrjes si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Prokurori i Përgjithshëm.
- c) Komisioni për Ekonominë dhe Financat (KEF), i cili kontrollon zbatimin e buxhetit nga këto insitucione në mënyrë indirekte, nëpërmjet raportimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga pikpamja formale dhe legalistike ky sistem kontrolli dhe mbikëqyrjeje mund edhe të qëndrojë, por nga analiza e funksionimit në praktikë, si në drejtim të marrjes së informacionit dhe llogaridhënies së institucioneve ashtu edhe mënyrës se si këto tre komisione i koordinojnë gjetjet e tyre, rezulton se ky mekanizëm funksionon vetëm formalisht.

Kështu nga studimi i procesverbaleve të sencave të pyetjeve nga deputetet e KPPÇLAPDNJ, mbas raportimeve të dy viteve të fundit të Avokatit të Popullit, por edhe në rezolutat e miratuara nga Kuvendi mbi këto raporte, nuk ka ndonjë detaj që të demonstrojë që zbatimi i legjislacionit

mbi përgjimet të këtë qënë në vëmëndje të ndonjë deputeti dhe të jetë ngritur si çështje qoftë edhe formalisht.

Po kështu, edhe mbas raportimeve të viteve të fundit të PP në KPPÇLAPDNJ apo në seancë plenare, interesi i deputetëve për të kërkuar detaje nga PP mbi mënyrën se si ky institucion e ushtron tërësinë e kompetencave të sipërpërmendura në zbatim të legjislacionit mbi përgjimet është minimal dhe në të njëjtën mënyrë edhe predispozicioni i PP për të raportuar.⁶⁷

Edhe në raportin e Ministrisë të Drejtësisë në Kuvend për inspektimet e kryera në Prokurori nga Ministria e Drejtësisë, por edhe në diskutimet e deputetëve kontrolli i zbatimit të ligjit mbi përgjimet nuk është prekur fare si çështje.⁶⁸

11. Dy modele

Për të parë se si një mbikqyrje nga ekzekutivi, parlamenti dhe institucione të pavarura mbi procesin e përgjimeve mund të realizohet sipas një standardi të dëshiruar, janë sjellë në këtë studim baza ligjore, institucionale dhe praktika e mbikqyrjes së përgjimeve në Francë dhe Britani (megjithëse duhet përmendur se modele të tjera të demokracive të reja Europiane mund të jenë më pranë praktikës sonë). Këto dy modele janë përzgjedhur edhe për arsye sepse përfaqësojnë dy modele të ndryshme të praktikës ligjore dhe institucionale në Europë. Pjesërisht për mënyrën e kontrollit nga ekzekutivi u fol më sipër.

Sipas legjislacionit dhe praktikës franceze, autoriteti kryesor për mbikqyrjen e përgjimeve është Komisioni Kombëtar për Kontrollin e Interceptimeve të Sigurisë (KKKIS).⁶⁹ Kryetari i këtij komisioni emërohet për një periudhë gjashtë vjeçare nga Presidenti Francez dhe ka në përbërje një deputet dhe një senator.⁷⁰

KKKIS kontrollon *a priori* procesin e përgjimeve nëpërmjet detyrimit ligjor të Kryeministrit për të njoftuar brenda 48 orëve komisionin për çdo vendim për përgjim. Komisioni shqyrton brenda shtatë ditëve ligjshmërinë e vendimit dhe në rast se e gjykon të pamotivuar, i dërgon

⁶⁷ Procesverbal i Raportimit të Prokurorisë së Përgjithshme në KPPÇLAPDNJ, datë 25.05.2010

⁶⁸ Procesverbal i raportimit të Ministrisë të Drejtësisë për inspektimet e kryera në Prokurori nga Ministria e Drejtësisë në KPPÇLAPDNJ, datë 01.06.2010

⁶⁹ Interceptime të sigurisë ka kuptimin e interceptimeve që nuk merren sipas këtij ligji, por jo ato që merren sipas Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁰ Loi n°91-646 du 10 juillet 1991 relative au secret des correspondances émises par la voie des communications électroniques. NOR: JUSX9100068L .Version consolidée au 31 décembre 2008. Article 13

Kryeministrit një rekomandim për ndërprerjen e menjëhershme të përgjimit. Rekomandimi i dërgohet gjithashtu edhe titullarit të institucionit që ka kërkuar përgjimin.⁷¹

Kontrulli *a posteriori* nga KKKIS realizohet në dy forma. Së pari, komisioni ka të drejtë për të bërë kontrolle verifikimi të procesit të përgjimit me iniciativë apo në bazë të reklamimit nga ‘çdo person që ka interes direkt dhe personal’. Nëse gjendet se përgjimi kryhet në kundërshtim me dispozitat e ligjit komisioni i rekomandon Kryeministrit ndërprerjen e përgjimit. Institucionet që kryejnë përgjim janë të detyruara të marrin të gjitha masat për lehtësimin e kësaj praktike.⁷² Së dyti, komisioni i paraqet Kryeministrit një raport vjetor mbi rezultatet e kontrollit, i cili bwhet publik,⁷³ dhe gjendet edhe në version elektronik.⁷⁴

Raportet që kryesisht janë mbi 100 faqe përmbajnë detaje për numrin dhe metodologjinë e kontrolleve etj. Në tabelat e mëposhtme janë disa detaje statistike mbi përgjimet në Francë.

| | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|----------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Siguria Kombëtare | 548 | 625 | 622 | 479 | 567 |
| Potenciali ekonomik dhe shkencor | 66 | 43 | 47 | 52 | 38 |
| Terrorizmi | 1 292 | 1 468 | 1 330 | 1 295 | 1 138 |
| Krimi i organizuar | 1 881 | 2 006 | 2 195 | 2 381 | 2 565 |
| Grupe (kriminale) të shpërbëra | 0 | 2 | 9 | 8 | 22 |
| Total | 3 787 | 4 144 | 4 203 | 4 215 | 4 330 |

Tabelë 1. Kërkesa për përgjime në pesë vite në Francë 75

| | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|----------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Siguria Kombëtare | 629 | 624 | 735 | 793 | 754 |
| Potenciali ekonomik dhe shkencor | 36 | 42 | 28 | 20 | 23 |
| Terrorizmi | 1 050 | 848 | 794 | 779 | 551 |
| Krimi i organizuar | 201 | 182 | 243 | 251 | 275 |
| Grupe (kriminale) të shpërbëra | 0 | 1 | 9 | 7 | 2 |
| Total | 1 918 | 1 697 | 1 809 | 1 850 | 1 605 |

Tabelë 2. Kërkesa për zgjatje përgjimi në pesë vite në Francë

⁷¹ Loi n°91-646 du 10 juillet 1991 relative au secret des correspondances émises par la voie des communications électroniques. NOR: JUSX9100068L .Version consolidée au 31 décembre 2008. Article 14

⁷² Ibid, Article 15-16

⁷³ Ibid, Article 19

⁷⁴ www.ladocumentationfrancaise.fr

⁷⁵ Commission Nationale de Contrôle des Interceptions de Sécurité. 17^e Rapport d'activité, Année 2008. La documentation Française

Sipas legjislacionit dhe praktikës britanike, autoriteti kryesor për mbikqyrjen e përgjimeve është Komisioneri për Interceptimin e Komunikimeve (KIK). KIK, i cili duhet të ketë mbajtur një pozicion të lartë në gjyqësor, zgjidhet për për një mandat tre vjeçar dhe mbikqyr:

- a) rolin e Sekretarit të shtetit në miratimin e vendimeve për përgjim,
- b) procedurat e ndjekura nga çdo institucion i cili merr pjesë në përgjim
- c) procedurat e ndjekura nga institucionet që asistojnë përgjimin
- d) përshtatshmërinë e masave të marra nga Sekretari i Shtetit në trajtimin dhe mbrojtjen e materialeve të interceptuara.⁷⁶

Regjimi i punës mbikqyrëse tw KIK përmban dy vizita në vit tek ato agjenci të cilat kryejnë përgjim me vendime dhe në zyrat e interesuara me këtë proces të Sekretarit të Shtetit. Ai kryen gjithashtu vizita tek operatorët që ofrojnë komunikime. Të gjithë punonjësit e institucioneve të mbikqyrura janë të detyruar që të japin çdo informacion që ndihmon KIK në kryerjen e funksionit të tij.

Të gjitha shkeljet e legjislacionit raportohen nga KIK dhe përfshihen në raportin vjetor drejtuar Kryeministrit, i cili një kopje të këtij raporti ia paraqet parlamentit. Raporti ka dy pjesë, pjesën e cila mund të bëhet publike dhe një pjesë e cila nuk publikohet për arsye të mos kompromentimit të punës së shërbimeve informative dhe të zbatimit të ligjit.

Në tabelën e mëposhtme janë disa të dhëna statistikore mbi përgjimet në Britani.

| | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|--|---|---|---|---|---|
| Vendime të miratuara nga Sekretari i Shtetit | 674 ^a 1849 ^b | 553 ^a 2243 ^b | 754 ^a 1333 ^b | 929 ^a 1881 ^b | 844 ^a 1881 ^b |
| Vendime të miratuara nga Autoriteti Skocez | 34 ^a 124 ^b | 43 ^a 164 ^b | 43 ^a 102 ^b | 28 ^a 145 ^b | 43 ^a 102 ^b |
| Total | 708^a 1973^b | 596^a 2407^b | 797^a 1435^b | 957^a 2026^b | 887^a 1983^b |

Tabelë 3. Vendime për përgjime në pesë vite në Britaninë e Madhe

Burimi: Ndërtuar me të dhëna nga raportet vjetore të KIK 2005-2009

(a – janë vendimet e mbartura në momentin e numërimit në 1 janar të çdo viti; b - janë vendimet e miratuara nga data 1 janar deri në 31 dhjetor të çdo viti)

⁷⁶ ‘Report of the Interception of Communications Commissioner for 2008’, Presented to Parliament by the Prime Minister pursuant to section 58(6) of the Regulation of Investigatory Powers Act 2000

Të dhënat statistikore janë të rëndësishme për të informuar publikun për shkallën e përdorimit të kësaj procedure dhe gjeneruar një debat të informuar pasi vetëm nga krahasimet e shifrave mund të dilet në një qëndrim të caktuar në lidhje me këtë diskutim.

Kështu nga krahasimi i të dhënave të mësipërme për përmasat e përdorimit të përgjimeve dhe atyre në disa vënde të tjera del se vendi me numrin më të lartë i personave të përgjuar në Europë është Italia me 76 në 100.000 banorë, e ndjekur nga Holanda me 62 vetë në 100.000, dhe Zvicra me 32 vetë në 100.000 banorë.⁷⁷

12. Konkluzione dhe rekomandime

Legjislacioni që rregullon përgjimin e telekomunikimeve është i paplotë dhe jo i mirëharmonizuar me legjislacionin organik të institucioneve informative dhe policore që përdorin përgjimin.

Duke qënë se, ndryshe nga eksperiencia e vendeve të tjera, ku informimi dhe debati mbi përdorimin e metodave të veçanta të hetimit ka qënë i mjaftueshëm për arsye të raporteve publike apo çështjeve gjyqësore të cilat kanë shërbyer edhe si referencë për Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut,⁷⁸ në prag të miratimit të ligjit për përgjimet në Shqipëri nuk pati ndonjë diskutim të gjerë publik.

Kështu, drafti i ligjit për përgjimin e telekomunikimeve u ndërtua duke u mbështetur pjesërisht në traditën e deriatëhershme duke i dhënë kompetenca të konsiderueshme PP, por pa i balancuar këto kompetenca me mekanizma kontrolli të ekzekutivit, legjislativit dhe institucioneve të pavarura.

Në këto kushte, përveç nevojës për t'u plotësuar me klauzola që të përmirësojnë kapacitet e përgjimit, duke pasur parasysh edhe komunikimet nëpërmjet internetit, të cilat legjislacioni aktual nuk i rregullon në asnjë instancë, është i nevojshëm rishikimi i tërë kuadrit për të shmangur përdorimet abuzive. Kështu, kuadri aktual nuk ka mekanizma si për parandalimin, ashtu edhe për verifikimin e disa abuzimeve të mundshme:

- për garantimin e klauzolës që sistemi të jetë i ndarë, pasi teknikisht njëra pjesë mund të kryejë të dy funksionet;

⁷⁷ Duncan Kennedy, 'Italian bill to limit wiretaps draws fire', 11 June 2010, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/world/europe/10279312.stm>

⁷⁸ H.Born & I. Leigh 'Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. (f.41)

- për të shmangur përgjimin e paligjshëm nëse dy institucionet kryesore për përgjimin bien dakord ta përdorin sistemin jashtë kërkesave ligjore;
- për përgjimet në situata emergjente;
- për garantimin që paisjet e miratuara për përgjim i përkasin subjekteve nën hetim,
- për përgjimet me kërkesë të njëjës palë,
- për procedurat e emërimit të personelit që meret me përgjimet për të garantuar që të mos jenë nën presion dhe të shmangin kërkesat ligjore,
- për procedurat minimizuese në mënyrë që të ndalohet marrja dhe përdorimi i atyre informacioneve personale që janë të pavlefshme për hetimin, etj.

Gjithashtu duhet që legjislacioni të përcaktojë në mënyrë të qartë kompetencat e ekzekutivit, të krijojë një institucion të pavarur kontrolli i cili t'i raportojë si ekzekutivit ashtu edhe legjislativit. Legjislativi duhet që të krijojë kapacitetet dhe ekspertizën e nevojshme për të vlerësuar dhe mbikëqyrur tërë mekanizmat e tjerë të kontrollit.

Bibliografia

1. Arjan Dyrmishi, "Interceptimi i Komunikimeve në Shqipëri: Kontrolli dhe Mbikqyrja", IDN, Qendra për Studime të Sigurisë. Maj 2009
www.idmalbania.org/publications/alb/Bacgrounder_Intercept.pdf
2. A.Rama, "Sollaku Shqipëria përgjime sa SHBA", Gazeta Shekulli 13 Mars 2007,
<http://www.shekulli.com.al/news/45/ARTICLE/6270/2007-03-13.html>
3. Council Resolution of 17 January 1995 on the lawful interception of telecommunications
Official Journal C 329, 04/11/1996 P. 0001 - 0006
4. Council of Europe, 'Guidelines on human rights and the fight against terrorism', Adopted by the Committee of Ministers on 11 July 2002 at the 804th meeting of the Ministers' Deputies,
<http://www1.umn.edu/humanrts/instreet/HR%20and%20the%20fight%20against%20terrorism.pdf>
5. Commission Nationale de Contrôle des Interceptions de Sécurité. 17^e Rapport d'activité, Année 2008. La documentation Française
6. Duncan Kennedy, 'Italian bill to limit wiretaps draws fire', 11 June 2010,
<http://news.bbc.co.uk/2/hi/world/europe/10279312.stm>
7. EP REPORT, PE 229.986/fin.A4-0243/99, 23 April 1999, on the draft Council Resolution on the lawful interception of telecommunications in relation to new technologies (10951/2/98 - C4-0052/99 - 99/0906(CNS))
8. Foreign Intelligence Surveillance Act. US Code Collection, Title 50, Chapter 36,
<http://www.law.cornell.edu/uscode/50/ch36.html>
9. H. Born and I. Leigh 'Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies
10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
11. Kodi i Procedurës Penale, I përditësuar me praktikë gjyqësore, Dhjetor 2008
12. Ligj Nr. 7495, datë 2.7.1991, Për Organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar
13. LigjNr.8391, datë 28.10.1998, Për Shërbimin Informativ Kombëtar
14. Ligj Nr.9074, Datë 29.5.2003 Për Shërbimin Informativ Ushtarak

15. Ligj Nr.9885, Datë 3.3.2008, Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr.9157, Datë 4.12.2003, “Për Përgjimin e Telekomunikimeve”, dhe Ligj Nr.10 172, Datë 22.10.2009, Për disa Shtesa në Ligjin Nr.9157, Datë 4.12.2003 “Për Përgjimin e Telekomunikacioneve”,
16. Ligj Nr. 9749, datë 4.6.2007, Për Policinë e Shtetit
17. Ligj Nr.10 002, datë 6.10.2008, Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme
18. Raportim i Prokurores së Përgjithshme të Republikës, ‘Mbi Gjendjen e Kriminalitetit në Shqipëri për Vitin 2009
19. Ligj Nr.8391, datë 28.10.1998, Për Shërbimin Informativ Kombëtar, ndryshuar me Ligj Nr. 9400, datë 12.5.2005
20. Ligj Nr.8737, datë 12.2.2001, Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë,(ndryshuar me Vendim të Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 13.02.2002 , me ligjin nr. 9102, datë 10.07.2003, me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008),
21. Ligji Nr.8454, datë 4.2.1999, Për Avokatin e Popullit, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005
22. Loi n°91-646 du 10 juillet 1991 relative au secret des correspondances émises par la voie des communications électroniques.NOR: JUSX9100068L. Version consolidée au 31 décembre 2008.
23. Raport për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, 1 Janar – 31 Dhjetor, Viti 2006
http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/Raporti_2006.pdf
24. Ligj Nr.8737, datë 12.2.2001, Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë,
25. Ministry of Justice, Fact Sheet on the Special Investigation Powers Act
<http://www.justitie.nl/english/Publications/factsheets/bob.asp?ComponentID=35268>
26. Procesverbal i Raportimit të Prokurorisë së Përgjithshme në KPPÇLAPDNJ, datë 25.05.2010
27. Regulation of Investigatory Powers Act 2000 (c. 23),
http://www.opsi.gov.uk/acts/acts2000/ukpga_20000023_en_2#pt1-ch1
28. Rregullorja e Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, ndryshuar me vendimin nr. 193, datë 7.7.2008
29. Procesverbal i raportimit të Ministrit të Drejtësisë për inspektimet e kryera në Prokurori nga Ministria e Drejtësisë në KPPÇLAPDNJ, datë 01.06.2010

30. Report of the Interception of Communications Commissioner for 2008', Presented to Parliament by the Prime Minister pursuant to section 58(6) of the Regulation of Investigatory Powers Act 2000
31. Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm Nr.1 Datë 21.04. 2006, 'Për Përgjimet'
<http://www.pp.gov.al/sq/home/legjislacion/Ligje/akte%20normative%20te%20PP/UDHEZIME/2002%20-%202006/7.pdf>